**VENDIM**
**Nr.351, datë 29.4.2020**

**PËR RISHPËRNDARJE FONDESH NË BUXHETIN E VITIT 2020, NDËRMJET MINISTRISË SË FINANCAVE DHE EKONOMISË DHE MINISTRISË SË INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 44, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të ligjit nr.88/2019, "Për buxhetin e vitit 2020", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në buxhetin e vitit 2020, miratuar për Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, bëhet rishpërndarja e fondeve, si më poshtë vijon:

a) Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, në programin buxhetor "Menaxhimi i të ardhurave tatimore" 01140, i shtohet fondi prej 26 000 000 (njëzet e gjashtë milionë) lekësh në shpenzime kapitale, për projektin "Blerje shërbim automatizimi dhe monitorimi aktiviteti për inspektorët", me vlerë të plotë projekti 127 440 000 (njëqind e njëzet e shtatë milionë e katërqind e dyzet mijë) lekë.

b) Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, në programin buxhetor "Transporti rrugor" 04520, i pakësohet fondi prej 26 000 000 (njëzet e gjashtë milionë) lekësh në shpenzime kapitale.

2. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
**Edi Rama**